



Strasbourg, 19 nëntor 2002

KKGjE (2002) Op. Nr 3

Këshilli Këshillëdhënës i Gjyqtarëve Evropian (KKGjE)

Opinion nr. 3 i Këshillit Këshillëdhënës të Gjyqtarëve Evropian (KKGjE) për vëmendjen e Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve në veçanti etikën, sjelljet e papërshtatshme dhe objektivitetin

1. Këshilli Këshillëdhënës i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) ka hartuar këtë opinion duke u bazuar në përgjigjet e Shteteve Anëtarë në pyetësorë dhe tekste të hartuara nga Pala Punuese e KKGJE-s dhe specialisti i lëndës i KKGJE-s, Z. Denis SALAS (Francë)
2. Opinioni aktual i referohet Opinioni Nr. 1 të KKGJE-s (2001) (www.coe.int/legalproof, CCJE(2001) 43) mbi standardet lidhur me pavarësinë e gjyqësorit dhe pandërrueshmërinë e gjyqtarëve, në veçanti paragrafët 13, 59, 60 dhe 71.
3. Gjatë përgatitjes së opinionit, KKGJE ka shqyrtuar disa dokumente tjera, posaçërisht:
 - “Parimet themelore të pavarësisë së gjyqësorit” të Kombeve të Bashkuara (1985)
 - Rekomandimin Nr. R (94) 12 të Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës më pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve;
 - Aktin Evropian mbi Statutin e Gjyqtarëve (1998) (DAJ/DOC(98)23);
 - Kodin e mirësjelljes gjyqësore, drafti Bangallore¹
4. Opinioni aktual mbulon dy fusha të rëndësishme:
 - Parimet dhe rregullat që rregullojnë mirësjelljen profesionale të gjyqtarëve bazuar në përcaktimin e parimeve etike të cilat duhet të arrijnë standarde shumë të larta dhe mund të inkorporohen në deklaratën e standardeve të mirësjelljes profesionale të hartuar nga vet gjyqtarët (A);
 - Parimet dhe procedurat që rregullojnë detyrimet penale, civile dhe disiplinore të gjyqtarëve (B).
5. Në këtë kontekst, KKGJE parashtron pyetjen nëse rregullat dhe principet ekzistuese ishin në të gjitha aspektet në përputhje me pavarësinë dhe objektivitetin e tribunaleve të kërkuara me Konventën Evropiane për Drejtat e Njeriut.
6. Prandaj, KKGJE kërkonte t’i përgjigjet pyetjeve në vijim:
 - Cilat standarde të mirësjelljes duhet të zbatohen nga gjyqtarët?
 - Si duhet formuluar standardet e mirësjelljes?
 - Nëse ka, çfarë përgjegjësie penale, civile dhe disiplinore duhet zbatuar gjyqtarët?

¹ Ky është rishikuar në nëntor 2002 për t’u shndërruar në Parimet e Bangallore të Mirësjelljes Gjyqësore. KKGJE nuk i ka pasur këto Parime më parë. Shënimet shpjeguese identifikojnë kontributin e Palës Punuese të KKGJE’s nga qershori 2002

7. KKGJE beson që përgjigjet në këto pyete do të kontribuojnë në implementimin e kornizës të planit global të veprimit për gjyqtarë në Evropë posaçërisht për prioritetet lidhur me drejtat dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve, mirësjelljen profesionale dhe etikën (shih dokumentin CCJE (2001) 24, Shtojca A, pjesa III B) dhe në këtë kontekst i referohet konkludimeve në paragrafët 49, 50, 75, 76 dhe 77 më post.

A. STANDARDET E MIRËSJELLJES GJYQËSORE

8. Aspektet etike të mirësjelljes së gjyqtarëve duhet të diskutohen për shkak të arsyeve të ndryshme. Metodot e përdorura në zgjidhjen e kontesteve gjithmonë duhet të shfaqin mirëbesim. Kompetencat e caktuara gjyqtarëve janë pikërisht të lidhura me vlerat e drejtësisë, së vërtetës dhe lirisë. Standardet e mirësjelljes që zbatohen nga gjyqtarët janë konkluzion i këtyre vlerave dhe një parakusht për mirëbesim në administrimin e drejtësisë.
9. Mirëbesimi në sistemin e drejtësisë është edhe më i rëndësishëm për rritjen e globalizimit të kontesteve dhe qarkullim të gjerë të gjykimeve. Për më tepër, në një Shtet ku mbizotëron ligji, publiku mund të pret parime të përgjithshme, të përputhshme me nocion për një gjykim të drejtë që garanton drejtat themelore. Obligimet i ngarkohen gjyqtarëve për të garantuar objektivitetin e tyre dhe efikasitetin e veprimeve të tyre.

1^o) Cilat standarde të mirësjelljes duhet të zbatohen nga gjyqtarët?

10. Çdo analizë e rregullave që rregullojnë kërkesat profesionale që vlejnë për gjyqtarët duhet të përfshijnë shqyrtimin e parimeve themelore dhe objektivave të caktuar.
11. Çfarëdo metode që përdoret për rekrutimin dhe trajnimin e tyre dhe çfarëdo mandati të gjerë që kanë, gjyqtarëve iu besohen kompetenca dhe funksionojnë në sfera që ndikojnë në cilësinë e jetës së njerëzve. Një raport i fundit hulumtues thekson që nga të gjitha autoritetet publike, gjyqësori është ai që ka ndryshuar më së shumti në vendet Evropiane.² Vitet e fundit, shoqëritë demokratike kanë vendosur kërkesa më të mëdha në sistemet gjyqësore. Pluralizmi në rritje i shoqërive tona bën që secili grup të kërkojë mirënjohje apo mbrojtje të cilën nuk e fiton gjithmonë. Përderisa arkitektura e demokracive është ndikuar thellësisht, variacione nacionale mbesin të shënuara. Është e vërtetë që vendet e Evropës Lindore që janë duke dalë nga regjime autoritare konsiderojnë që ligji dhe drejtësia ofrojnë legjitimitetin e nevojshëm për rindërtimin e demokracisë. Aty më shumë se tjetërkund sistemi gjyqësorë është duke konfirmuar veten në lidhje me autoritetet tjera publike përmes funksioneve të veta të mbikëqyrjes gjyqësore.
12. Kompetencat e caktuara gjyqtarëve i nënshtrohen jo vetëm ligjit vendor, një shprehje e vullnetit të një kombi, por gjithashtu edhe parimeve të ligjit ndërkombëtarë dhe drejtësisë të pranuar në shoqëritë bashkëkohore demokratike.

² *Les mutations de la justice. Comparaisons européennes.* Ph. Robert dhe A. Cottino (ed.), Harmattan, 2001

13. Qëllimi për cilin këto kompetenca i caktohen gjyqtarëve është për t'iu mundësuar atyre administrimin e drejtësisë duke zbatuar ligjin dhe duke u siguruar që secili person gëzon drejtat dhe/ose asetet që janë ligjërish të tyre nga cilat kanë qenë apo mund të jenë të privuar padrejtësisht.
14. Ky qëllim është i shprehur në Nenin 6 të Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut e cila, nëse flitet nga këndvështrimi i shfrytëzuesve të sistemit gjyqësor parasheh që *“të gjithë kanë drejtë në dëgjim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga tribunali i pavarur dhe paanshëm i themeluar sipas ligjit”*. Duke mos sugjeruar që gjyqtarët janë të gjithëfuqishëm, Konventa thekson mbrojtjet që janë vendosur për persona gjatë gjykimit dhe parimet mbi cilat themelohen detyrat e gjyqtarit: pavarësia dhe objektiviteti.
15. Vitet e fundit, është identifikuar nevoja për një siguri të rritur të pavarësisë dhe objektivitetit të gjyqësorit; janë krijuar organe të pavarura për të mbrojtur gjyqësorin nga ndërhyrja partizane; rëndësia e Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut është zhvilluar dhe kërkuar përmes praktikës së Gjykatës Evropiane në Strasburg dhe gjykatat nacionale.
16. Pavarësia e gjyqtarëve është një parim themelor dhe e drejtë e qytetarit e secilit Shtet duke përfshirë gjyqtarët. Ka aspektin institucional si dhe individual. Shteti bashkëkohor demokratik duhet të themelohen mbi ndarjen e kompetencave. Çdo gjyqtarë individual duhet t'i bëjë gjitha për të siguruar pavarësinë gjyqësore në nivel institucional si dhe individual. Arsyetimi për një pavarësi të tillë është diskutuar hollësisht në Opinionin Nr. 1 (2001) të KKGJE-s, paragrafët 10-13. Siç është cekur aty, ajo është e kompletuar nga dhe parakushti i objektivitetit të gjyqtarit që është e rëndësishme për kredibilitetin e sistemit gjyqësorë dhe mirëbesimin që do të ngjall ajo në një shoqëri demokratike.
17. Neni 2 i *“Parimeve themelore të pavarësisë së gjyqësorit”* të hartuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1985 parasheh që *“gjyqësori do të vendos mbi çështjet në mënyrë të paanshme duke u bazuar në faktet dhe në përputhje me ligjin pa ndonjë kufizim, ndikim të pavend, nxitje, presion, kërcënim apo ndërhyrje, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nga askush apo për çfarëdo arsye”*. Sipas Nenit 8, gjyqtarët *“gjithmonë do të sillen në atë mënyrë për të ruajtur dinjitetin e zyrës së tyre dhe paanshmërinë dhe pavarësinë e gjyqësorit”*.
18. Në Rekomandimin N^o R (94) 12 për pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve (Parimi I.2.d), Komisioni i Ministrave të Këshillit të Evropës parasheh që *“gjyqtarët duhet të kenë lirinë e papenguar për të vendosur në mënyrë objektive në përputhje me ndërgjegjen e tyre dhe interpretimin e tyre të fakteve dhe duke zbatuar rregullat mbizotëruese të ligjit”*.
19. Akti Evropian për Statutin e Gjyqtarëve parasheh që statuti i gjyqtarëve duhet të sigurojë objektivitetin të cilin të gjithë anëtarët e publikut presin nga gjykatat (paragrafi 1.1). KKGJE plotësisht përkrah këtë dispozitë të Aktit.

20. Objektiviteti përcaktohet nga Gjykata Evropiane sipas qasje *subjektive*, që shqyrton bindjet personale apo interesat e një gjyqtari në një rast të caktuar dhe sipas testit *objektiv* që përcakton nëse gjyqtari ka ofruar mjaft garancion për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë aspekt.³
21. Në çdo rrethanë gjyqtarët duhet të veprojnë me objektivitet për të siguruar që të mos ketë arsye legjitime që qytetari të dyshojë për njëanshmëri. Lidhur me këtë, paanshmëria duhet të jetë e dukshme gjatë zbatimit të funksioneve gjyqësore të gjyqtarit dhe aktivitetet tjera të tij apo saj.
- a. **Objektiviteti dhe sjellja e gjyqtarëve në zbatimin e funksioneve gjyqësore**
22. Mirëbesimi publik në dhe respekti për gjyqësorin janë garancion të efektivitetit të sistemit gjyqësor: sjellja e gjyqtarëve në aktivitetet e tyre profesionale kuptohet që konsiderohet nga anëtarët e publikut si thelbësore për kredibilitetin e gjykatës.
23. Prandaj, gjyqtarët duhet të kryejnë detyrat e veta pa ndonjë favoritizëm, shfaqje të paragjykimi apo njëanshmëri. Ata nuk duhet të marrin vendimet duke shqyrtuar atë që është jashtë zbatimit të rregullave të ligjit. Përderisa janë duke trajtuar rastin apo mund të kërkohet të bëjnë, nuk duhet me vetëdije të bëjnë ndonjë vështrim që me arsye mund të sugjerojë ndonjë shkallë të paragjykimit të zgjedhjes së kontestit apo që mund të ndikojë në drejtësinë e procedurës. Ata duhet të shfaqin konsideratë për të gjithë personat (palët, dëshmitarët, këshilltarët) pa dallim bazuar në themele të paligjshme apo të papërshtatshme me realizimin e duhur të funksioneve të tyre. Ata gjithashtu duhet të sigurohen që kompetenca e tyre profesionale të jetë e qartë në realizimin e detyrave të tyre.
24. Gjithashtu gjyqtarët duhet të realizojnë funksionet e tyre duke respektuar parimin e trajtimit të barabartë të palëve dhe duke shmangur çdo njëanshmëri dhe diskriminim dhe të mirëmbajnë baraspeshën ndërmjet palëve për të siguruar që secili të përfitoj një dëgjim të drejtë.
25. Efektiviteti i sistemit gjyqësor gjithashtu kërkon që gjyqtarët të kenë një shkallë më të lart të njohurive profesionale. Ata duhet të sigurohen që mbajnë një shkallë të lart të kompetencës profesionale përmes trajnimit themelor dhe të avancuar që iu ofron atyre kualifikimet e duhura.
26. Gjithashtu gjyqtarët duhet të përmbushin funksionet e tyre me kujdes dhe shpejtësi të arsyeshme. Për këtë, natyrisht që është e nevojshme që ata të kenë objektet e duhura, pajisjet dhe ndihmën. Gjithashtu, gjyqtarët duhet të jenë të kujdesshëm ndaj dhe të kenë mundësi të

³ Shih për shembull rastin Piersack, gjykimi më 1 tetor 1982, Seria A 53, paragrafi 30, rasti De Cubber, gjykimi më 26 tetor 1984, Seria A 86, paragrafi 24, rasti Demicoli, gjykimi më 27 gusht 1991, Seria A 210, paragrafi 40, rasti Sainte-Marie, gjykimi më 16 dhjetor 1992, Seria A 252-A, paragrafi 34.

kryejnë obligimet e tyre sipas Nenit 6.1 të Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut për gjykim brenda kohës së arsyeshme.

b. Objektiviteti dhe sjellja e gjyqtarëve jashtë gjyqësorit

27. Gjyqtarët nuk duhet të izoloohen nga shoqëria në cilën jetojnë pasi që sistemi gjyqësor mund të funksionoj si duhet vetëm nëse gjyqtarët janë në komunikim me realitetin. Gjithashtu, si qytetarë, gjyqtarët gëzojnë drejtat themelore dhe posaçërisht liritë e mbrojtura nga Konventa Evropiane për Drejtat e Njeriut (liria e të menduarit, liria e religjionit etj). Prandaj, ata duhet të jenë kryesisht të lirë për t'u përfshirë në aktivitete jashtë profesionit sipas zgjedhjes së tyre.
28. Megjithatë, aktivitetet e tilla mund të rrezikojnë objektivitetin e tyre apo ndonjëherë edhe pavarësinë e tyre. Duhet të ekzistojë një baraspeshë e arsyeshme ndërmjet shkallës në cilën gjyqtarët mund të përfshihen në shoqëri dhe nevojës për të qenë dhe për t'u shikuar si të pavarur dhe paanshëm në realizimin e detyrave të tyre. Në analizën e fundit, gjithmonë duhet parashtruar pyetjen nëse posaçërisht në kontekst social dhe në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm dhe të informuar, gjyqtari është përfshirë në një aktivitet që mund të komprometoj objektivisht pavarësinë apo paanshmërinë e tij apo saj.
29. Gjyqtarët duhet të sillen në mënyrë të respektueshme në jetën e tyre private. Sa i përket llojllojshmërisë kulturore të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës dhe evoluimit të vazhdueshëm të vlerave morale, standardet që vlejné për sjelljen e gjyqtarëve në jetët e tyre private nuk mund të vendosen në mënyrë të saktë. KKGJE inkurajon vendosjen brenda gjyqësorit të një apo më shumë organeve apo personave me rol këshillëdhënës dhe në dispozicion për gjyqtarët kurdoherë që ata të kenë ndonjë pasiguri nëse ndonjë aktivitetet në fushën private është në përputhje me statusin e tyre si gjyqtarë. Prania e organit apo personave të tillë mund të inkurajoj diskutime brenda gjyqësorit për përmbajtjen dhe rëndësinë e rregullave etike. Për të shqyrtuar dy mundësi, organet apo personat e tillë mund të vendosen nën mbrojtjen e Gjykatës Supreme apo shoqatës së gjyqtarëve. Ata duhet të jetë ndaras dhe të ndjekin objektiva të ndryshëm nga organet ekzistuese përgjegjëse për sanksione disiplinore.
30. Pjesëmarrja e gjyqtarëve në aktivitete politike paraqet probleme kryesore. Natyrisht, gjyqtari mbetet qytetarë dhe duhet të ketë mundësi të ushtroj drejtat politike sikur të gjithë qytetarët. Megjithatë, sa i përket drejtës për gjykim të drejtë dhe pritje legjitime të publikut, gjyqtarët duhet të shfaqin përmbajtje nga ushtrimi i aktivitetit publik politik. Disa Shtete kanë përfshirë këtë parim në rregullat e veta disiplinore dhe sanksionojnë çdo sjellje që bie në konflikt me obligimin e gjyqtarit për të ushtruar përmbajtje. Gjithashtu, shprehimisht e kanë cekur që detyrat e gjyqtarit nuk janë në përputhje me disa mandate politike (në parlament nacional, Parlament Evropian apo këshill lokal), madje disa herë duke ndaluar bashkëshortët e gjyqtarëve që të marrin qëndrime të tilla.

31. Në përgjithësi, është e nevojshme të konsiderohet pjesëmarrja e gjyqtarëve në debate publike të natyrës politike. Në mënyrë që të ruhet mirëbesimi i publikut në sistemit gjyqësor, gjyqtarët nuk duhet të ekspozohen ndaj sulmeve politike që nuk janë në përputhje me neutralitetin e kërkuar nga gjyqësori.
32. Duke lexuar përgjigjet në pyetësor, duket që në disa Shtete është marr qëndrim kufizues për përfshirjen e gjyqtarëve në politikë.
33. Diskutimi brenda KKGJE-s ka treguar nevojën për të krijuar një baraspeshë ndërmjet lirisë të menduarit të gjyqtarit dhe të shprehurit dhe kërkesën për neutralitet. Prandaj, është e nevojshme që gjyqtarët edhe pse anëtarësimi i tyre në parti politike apo pjesëmarrja në debate politike për problemet kryesore të shoqërisë nuk mund të ndalohej, së paku të përmbahen nga ndonjë aktivitet politik që ka mundësi të komprometoj pavarësinë e tyre apo rrezikojë imazhin e objektivitetit.
34. Megjithatë, gjyqtarët duhet të lejohen të marrin pjesë në debate të caktuara lidhur me politikat shtetërore gjyqësore. Ata duhet të kenë mundësi të konsultohen dhe të jenë pjesë aktive në përgatitjen e legjislacionit lidhur me statutin e tyre dhe në përgjithësi funksionimin e sistemit gjyqësor. Kjo çështje gjithashtu paraqet pyetjen nëse gjyqtarët duhet të jenë të lejuar t'i bashkohen sindikatave. Sipas lirisë së tyre të shprehurit dhe të menduarit, gjyqtarët mund të ushtrojnë të drejtën për t'u bashkuar në sindikata (liria e asociacionit) edhe pse mund të caktohen kufizime sa i përket drejtës për grevë.
35. Puna në një fushë tjetër iu ofron gjyqtarëve një mundësi për të zgjeruar njohuritë dhe iu jap atyre informata për problemet në shoqëri që kompleton njohuritë e fituara nga ushtrimi i profesionit të tyre. Në të kundërtën, ajo përfshin disa rreziqe jo të papërfillshme: mund të konsiderohet që është në kundërshtime ndarjen e kompetencave dhe gjithashtu mund të dëmtoj mendimin e publikut për pavarësinë dhe objektivitetin e gjyqtarëve.
36. Çështja e përfshirjes së gjyqtarëve në aktivitete të caktuara shtetërore siç është shërbimi në zyrat private të ministrit (*cabinet ministeriel*), paraqet problem të veçantë. Asgjë nuk e parandalon gjyqtarin nga ushtrimi i funksioneve në një departament administrativ të një ministrie (për shembull departamenti për legjislacion penal apo civil në Ministrinë e Drejtësisë); megjithatë, çështja është më delikate lidhur me gjyqtarë që bëhen pjesë e stafit të zyrës private të ministrit. Ministrat kanë drejtë të emërojnë kënd duan për të punuar në zyrën e tyre private por si bashkëpunëtorë të afërt të ministrit, stafi i tillë marrin pjesë në aktivitete politike të ministrit. Në rrethana të tilla një gjyqtarë para se të hyjë në shërbim në zyrën private të ministrit, duhet marr një opinion nga organi i pavarur përgjegjës për emërimin e gjyqtarëve ashtu që ky organ të mund të caktojë rregullat e sjelljes që mund të zbatohen në secilin rast individual.

c. Objektiviteti dhe aktivitetet tjera profesionale të gjyqtarëve⁴

37. Natyra specifike e funksionit gjyqësor dhe nevoja për të ruajtur dinjitetin e zyrës dhe për të mbrojtur gjyqtarët nga të gjitha llojet e presionit do të thotë që gjyqtarët duhet të sillen në atë mënyrë për t'iu shmangur konfliktit të interesit apo keqpërdorimit të kompetencave. Kjo kërkon që gjyqtarët të përmbahen nga ndonjë aktivitet profesional që mund t'i largoj ata nga përgjegjësitë gjyqësore apo të bëjë që ata të ushtrojnë pjesërisht përgjegjësitë e tilla. Në disa Shtete, mospërputhjet me funksionin e gjyqtarit janë të definuar qartë me statutin e gjyqtarit dhe anëtarët e gjyqësorit janë të ndaluar të kryejnë ndonjë aktivitet profesional apo me pagesë. Përjashtime janë bërë për aktivitete edukative, hulumtuese, shkencore, letrare apo artistike.
38. Shtete të ndryshme kanë trajtuar aktivitetet mospërputhëse me efekte të ndryshme (një përmbledhje e shkurtër është bashkëngjitur) dhe me procedura të ndryshme edhe pse në secilin rast me objektiv të përgjithshëm të shmangies së krijimit të pengesave të pakalueshme ndërmjet gjyqtarëve dhe shoqërisë.
39. KKGJE mendon që rregullat e mirësjelljes profesionale duhet të kërkojnë që gjyqtarët të largohen nga ndonjë aktivitet që mund të komprometoj dinjitetin e zyrës së tyre dhe të ruajnë besimin e publikun në sistemin gjyqësorë duke minimizuar rrezikun nga konflikti i interesit. Prandaj, ata duhet të përmbahen nga ndonjë aktivitet profesional shtesë që mund të kufizojë pavarësinë e tyre apo rrezikojë objektivitetin e tyre. Në këtë kontekst, KKGJE përkrah dispozitën e Aktit Evropian mbi Statutin e Gjyqtarëve sipas cilit liria e gjyqtarit për t'u përfshirë në aktivitete jashtë mandatit gjyqësorë "mund të mos kufizohet përpos nëse këto aktivitete nuk janë në përputhje me mirëbesimin në, apo objektivitetin apo pavarësinë e gjyqtarit apo disponueshmërinë që kërkohet nga ai apo ajo për t'i trajtuar çështjet e caktuara atij ose asaj me vëmendje dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor" (paragrafi 4.2). Akti Evropian gjithashtu pranon drejtën e gjyqtarit për t'u bashkuar në ndonjë organizatë profesionale dhe drejtën e të shprehurit (paragrafi 1.7) për të shmangur "ngurtësinë e tepruar" që mund të krijoj pengesa ndërmjet shoqërisë dhe vet gjyqtarëve (paragrafi 4.3). Megjithatë, është e rëndësishme që gjyqtarët të vazhdojnë të përkushtojnë shumicën e kohës rolit të tyre si gjyqtarë duke përfshirë aktivitetet e ndërlihdura dhe të mos provokohen për të kushtuar shumë vëmendje aktiviteteve jashtë gjyqësorit. Është e qartë që ekziston një rrezik më i lart nga vëmendja e tepërt kushtuar aktiviteteve të tilla, nëse lejohen për ndonjë shpërblim. Kufiri i saktë ndërmjet asaj se çfarë është e lejuar dhe çfarë nuk është e lejuar duhet të caktohet nga shteti në shtet dhe këtu ekziston roli për një organ apo person të tillë siç është paraparë me paragrafin 29 më lart.

d. Objektiviteti i marrëdhënieve të gjyqtarit me media

⁴ Për një analizë të hollësishme të mospërputhjeve, shih Komunikatën e Jean-Pierre Atthenont të paraqitur në seminar të organizuar nga Këshilli i Evropës mbi statutin e gjyqtarëve (Bukuresht, 19-21 mars 1997) dhe Komunikatën e Pierre Cornu të paraqitur në seminar të organizuar nga Këshilli i Evropës mbi statutin e gjyqtarëve (Chisinau, 18-19 shtator 1997)

40. Ka qenë një trend i përgjithshëm që vëmendja e medias të fokusohet në çështjet e gjyqësorit, posaçërisht në fushën penale dhe në veçanti në disa vende të Evropës Perëndimore. Duke pasur parasysh lidhjet që mund të krijohen ndërmjet gjyqtarëve dhe medias, ekziston rreziku që gazetarët të ndikojnë në mënyrën në cilën sillen gjyqtarët. Sa i përket kësaj lidhje, KKGJE në Opinionin e vet Nr. 1 (2001) thekson që derisa liria e shtypit ishte një parim i shquar, procesi gjyqësor është dashur të mbrohet nga ndikimi i jashtëm. Përputhshmërisht, gjyqtarët duhet të shfaqin kujdes në marrëdhëniet e tyre me mediet dhe të mund të ruajnë pavarësinë dhe objektivitetin e tyre duke u përmbajtur nga shfrytëzimi i marrëdhënieve personale me gazetarë dhe ndonjë koment të paarsyetuar për rastet që i trajtojnë. Drejta e publikut për informim është parim fundamental që rezulton nga Neni 10 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut. Ajo paraqet që gjyqtari i përgjigjet pritjeve legjitime të qytetarëve përmes vendimeve të motivuara qartas. Gjyqtarët duhet të jenë të lirë për të përgatitur një përmbledhje apo komunikatë që paraqet thelbin apo qartëson rëndësinë e gjykimeve të tyre për publikun. Përpos kësaj, për vendet ku gjyqtarët janë të përfshirë në hetime penale, është e këshillueshme që ata të koordinojnë përmbajtje të nevojshme lidhur me rastet që i trajtojnë me drejtë për informim. Vetëm në kushte të tilla gjyqtarët mund të përmbushin rolin e tyre pa frikë nga presioni i medias. KKGJE ka vëzhguar me interesim praktikën në fuqi në disa vende për emërimin e gjyqtarit me përgjegjësi për komunikim apo zëdhënës për të kontaktuar me media për lëndët që janë për interes të publikut.

2°) Si duhet formuluar standardet e mirësjelljes?

41. Tradita kontinentale gjyqësore përkrah fuqishëm idenë e kodifikimit. Disa vende tashmë kanë hartuar kodin e mirësjelljes në sektorin publik (policia), në profesione të sistemuara (avokatë, mjekë) dhe në sektorin privat (shtypi). Gjithashtu së fundi janë futur edhe kodet e etikës për gjyqtarë posaçërisht në vendet e Evropës Lindore duke përcjellë shembullin e Shteteve të Bashkuara.
42. Kodi më i vjetër është “Kodi Etik” Italian i aprovuar më 7 maj 1994 nga Shoqata Italiane e Gjyqtarëve, një organizatë profesionale e gjyqësorit. Fjala “kod” është e papërshtatshme pasi që përbëhet prej 14 neneve që mbulojnë mirësjelljen e gjyqtarëve (duke përfshirë kryetarët e gjykatave) në tërësi dhe përfshinë prokurorët publik.⁵ Është e qartë që kodi nuk përbëhet nga rregulla disiplinore apo penale, por është një instrument vet-rregullues që rrjedh nga vet gjyqësori. Neni 1 parasheh parimin e përgjithshëm: “Në jetën shoqërore, gjyqtari duhet të sillet me dinjitet dhe drejtësi dhe të jetë i kujdesshëm për interesin publik. Brenda kornizës së funksioneve të tij dhe në çdo veprim profesional, ai duhet të frymëzohet nga vlerat e indiferencës personale, pavarësisë dhe objektivitetit”.

⁵ Kodi mbulon raportet me individ, kompetencat, shfrytëzimin e burimeve publike, shfrytëzimin e informatave profesionale, raportet me media, anëtarësinë në shoqata, imazhin e paanshmërisë dhe pavarësisë, obligimin për të vepruar si duhet me bashkëpunues, mirësjellja në zyrë dhe jashtë dhe detyrat e gjyqtarëve kryesor.

43. Vendet tjera siç janë Estonia, Lituania, Moldavia, Sllovenia, Republika Çeke dhe Sllovakia kanë “kodit etik gjyqësor” apo “parimet e mirësjelljes” të aprovuar nga kuvendet përfaqësuese të gjyqtarëve dhe dallojnë nga rregullat disiplinore.
44. Kodet e mirësjelljes kanë disa përfitime të rëndësishme: së pari, ato ndihmojnë gjyqtarët për të zgjidhur çështjet e etikës profesionale duke iu dhënë atyre autonomi në vendim-marrje dhe garantuar pavarësinë e tyre nga autoritetet tjera. Së dyti, ato informojnë publikun për standardet e mirësjelljes që mund të presin nga gjyqtari. Së treti, ato kontribuojnë për të siguruar publikun që drejtësia administrohet në mënyrë të pavarur dhe të paanshëm.
45. Megjithatë, KKGJE thekson që pavarësia dhe objektiviteti nuk mund të mbrohen vetëm përmes parimeve të mirësjelljes dhe rregulla të numërta statusore dhe procedurale gjithashtu kanë një rol. Standardet e mirësjelljes profesionale dallojnë nga rregullat statusore dhe disiplinore. Ato shprehin aftësinë profesionale për të pasqyruar funksionin e vet në vlerat që janë në përputhje me pritjet e publikut duke plotësuar kompetencat e dhëna. Këto janë standarde vet-rregulluese që përfshijnë mirënjohjen që zbatimi i ligjit nuk është një ushtrim mekanik, ai përfshin diskrecionit e kompetencës dhe vendos gjyqtarin në raport të përgjegjësisë për veten dhe qytetarët.
46. Kodet e mirësjelljes profesionale gjithashtu krijojnë një numër problemesh. Për shembull, ato japin përshtypjen që përmbajnë të gjitha rregullat dhe që diçka që nuk është e ndaluar duhet të jetë e lejuar. Ato mund të thjeshtësojnë situatat dhe përfundimisht ato krijojnë përshtypjen që standardet e mirësjelljes rregullohen për një periudhë të caktuar kohore kurse në fakt ato janë në evoluim të vazhdueshëm. KKGJE sugjeron që është e dëshirueshme të përgatitet dhe të flitet për një “deklaratë të standardeve të mirësjelljes profesionale” se sa për kod.
47. KKGJE mendon që përgatitja e deklaratave të tilla duhet inkurajuar në çdo vend edhe pse ato nuk janë mënyra e vetme e shpërndarjes së rregullave të mirësjelljes profesionale pasi që:
- Trajnimi i duhur themelor dhe i avancuar duhet pasur rol në përgatitjen dhe shpërndarjen e rregullave të mirësjelljes profesionale;⁶
 - Në Shtetet ku ekzistojnë inspektoratet gjyqësore duke u bazuar në vështrimin e tyre të sjelljes së gjyqtarëve, ato mund të kontribuojnë në zhvillimin e të menduarit etik; mendimet e tyre mund të kumtohen përmes raporteve vjetore;
 - Përmes vendimeve të tyre, autoriteti i pavarur i përshkruar në Aktin Evropian mbi Statutin e Gjyqtarëve nëse është i përfshirë në procedurat disiplinore, thekson detyrat dhe obligimet e

⁶ Në raportin e tij përmbledhës të paraqitur pas takimit të parë të Rrjetit të Lisbonës, Daniel Ludet theksoi që trajnimi duhet ofruar një lidhje dhe të inkurajoj diskutimin për praktikat e gjyqtarëve dhe parimet etike në cilat janë bazuar ato (shih *Trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve për çështjet lidhur me obligimet e tyre profesionale dhe etikët*. Takimi i parë i anëtarëve të rrjetit për këmbimin e informatave mbi trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Botimet e Këshillit të Evropës).

gjyqtarëve; nëse këto vendime janë publikuar në formën e duhur, vetëdijesimi për vlerat themelore mund të ngritët në mënyrë më efektive;

- Grupet e nivelit të lart që përbëhen nga përfaqësues të interesave të ndryshëm të përfshirë në administrimin e drejtësisë mund të krijohen për të shqyrtuar çështjet etike dhe shpërndarjen e konkludimeve të tyre;
- Shoqatat profesionale duhet të veprojnë si forume për diskutime për përgjegjësitë dhe deontologjinë e gjyqtarëve; ato duhet të ofrojnë shpërndarje të gjerë të rregullave të mirësjelljes brenda qarqeve gjyqësore.

48. KKGJE dëshiron të theksoj që për të ofruar mbrojtjen e duhur të pavarësisë së gjyqtarëve, çdo deklaratë e standardeve të mirësjelljes profesionale duhet të bazohet në dy parime themelore:

- i) Së pari, ajo duhet adresuar parimet themelore të mirësjelljes profesionale. Ajo duhet identifikuar pamundësinë e përgjithshme të hartimit të listave komplete të aktiviteteve të paracaktuara të cilat gjyqtarët nuk janë të lejuar të ndjekin; parimet e cekura duhet të shërbejnë si instrumente vet-rregulluese për gjyqtarë dmth rregullat e përgjithshme që rregullojnë aktivitetet e tyre. Gjithashtu, edhe pse ekziston një fërkim dhe një bashkëveprim, parimet e mirësjelljes duhet të mbesin të pavarur nga rregullat disiplinore që aplikohen për gjyqtarë në kuptim që dështimi për të vështruar një nga parimet e tilla nuk duhet të përbëjë shkelje disiplinore apo shkelje penale apo civile;
- ii) Së dyti, parimet e mirësjelljes profesionale duhet të hartohen nga vet gjyqtarët. Ato duhet të jenë instrumente vet-rregulluese që rrjedhin nga vet gjyqësori, duke lejuar që autoriteti gjyqësor të fitoj legjitimitetin duke funksionuar brenda kornizës së standardeve etike të pranuar në përgjithësi. Duhet organizuar konsultime të gjëra mundësisht nën mbrojtjen e personit apo organit siç është cekur në paragrafin 29 që gjithashtu do të mund të ishte përgjegjës për shpjegimin dhe interpretimin e deklaratës së standardeve të mirësjelljes profesionale.

3°) Konkludimet mbi standardet e mirësjelljes

49. Mendimi i KKGJE-s është si në vijim:

- i) Gjyqtarët duhet të udhëhiqen nga parimet e mirësjelljes profesionale në aktivitetet e tyre,
- ii) Parimet e tilla duhet të ofrojnë gjyqtarëve udhëzime si të vazhdojnë dhe me këtë t'i mundësojnë atyre të tejkalojnë vështirësitë me cilat ballafaqohen lidhur me pavarësinë dhe objektivitetin e tyre,
- iii) Parimet në fjalë duhet të hartohen nga gjyqtarë dhe të jenë plotësisht të ndara nga sistemi disiplinorë për gjyqtarë,

- iv) E dëshirueshme është themelimi i një apo më shumë organeve në secilin shtet brenda gjyqësorit për të këshilluar gjyqtarët që ballafaqohen me ndonjë problem lidhur me etikën profesionale apo përputhjen e aktiviteteve jo-gjyqësore me statusin e tyre.

50. Sa i përket rregullave të mirësjelljes për secilin gjyqtarë, KKGJE mendon që:

- i) Secili gjyqtarë individual duhet të bëjë çmos për të ruajtur pavarësinë gjyqësore në nivel institucional dhe individual,
- ii) Gjyqtarët duhet të sillen me integritet në zyrë dhe në jetët e tyre private,
- iii) Në çdo moment ata duhet të kenë një qasje që është dhe duket e paanshme,
- iv) Ata duhet të kryejnë detyrat e tyre pa favorizim dhe paragjykim apo anshmëri të dukshme dhe aktuale
- v) Vendimet e tyre duhet të merren duke shikuar të shqyrtimet materiale për zbatimin e rregullave relevante të ligjit dhe duke përjashtuar nga shqyrtimi të gjitha që nuk janë materiale,
- vi) Duhet pasur konsideratë për të gjithë personat që marrin pjesë në procedurat gjyqësore apo që ndikohen nga këto procedura
- vii) Ata duhet të kryejnë detyrat e tyre duke respektuar trajtim të barabartë të palëve duke shmangur çdo njëanshmëri apo diskriminim duke ruajtur baraspeshën ndërmjet palëve dhe duke siguruar dëgjim të drejtë për secilin
- viii) Duhet të jenë të kujdesshëm në raport me media, të ruajnë pavarësinë e tyre dhe objektivitetin duke u përmbajtur nga shfrytëzimi personal i raporteve me media dhe nga komentet e paarsyeshme për rastet që janë duke trajtuar
- ix) Duhet siguruar që janë duke ruajtur shkallën e lart të kompetencës profesionale
- x) Ata duhet pasur shkallë të lart profesionale dhe t'i nënshtrohen obligimit për kujdes për të qenë në përputhje me kërkesat për të gjykuar në kohëzgjatje të arsyeshme
- xi) Duhet të ndajnë kohën më të madhe funksioneve gjyqësore duke përfshirë aktivitetet e ndërlidhura
- xii) Ata duhet të përmbahen nga aktivitetet politike që mund të komprometojnë pavarësinë e tyre dhe të dëmtojnë imazhin e tyre të objektivitetit.

B. PËRGJEGJËSITË PENALE, CIVILE DHE DISIPLINORE TË GJYQTARËVE

4°) Cilat përgjegjësi penale, civile dhe disiplinore duhet të zbatohen nga gjyqtarët?

51. Konkludimi për kompetencat dhe besimin e shoqërisë në gjyqtarë është që duhet pasur mjete që mbajnë gjyqtarët përgjegjës dhe madje largimin e tyre në raste të keqsjelljes aq të rëndë sa që të arsyetohet një veprim i tillë. Nevoja për kujdes në identifikimin e detyrimeve të tilla vjen nga nevoja për të ruajtur pavarësinë gjyqësore dhe lirinë nga presioni i panevojshëm. Lidhur me këtë historikë, KKGJE shqyrton lëndët të përgjegjësisë penale, civile dhe disiplinore. Në praktikë, më e rëndësishme është përgjegjësia potenciale disiplinore e gjyqtarëve.

a. Përgjegjësia penale

52. Gjyqtarët të cilët gjatë menaxhimit të zyrës së tyre veprojnë në mënyrë e cila në çfarëdo rrethana do të konsiderohej krim (p.sh. pranimi i mitos) nuk mund të ketë imunitet nga proceset e rregullta penale. Përgjigjet në pyetësor tregojnë që në disa vende madje edhe mossukseset gjyqësore me qëllim të mirë mund të përbëjnë krim. Prandaj, në Suedi dhe Austri, gjyqtarët (duke u asimiluar në funksione tjera publike) mund të dënohen (p.sh. me gjoba) në disa raste të neglizhencës së rëndë (p.sh. që përfshin burgimin e dikujt për një kohë shumë të gjatë).
53. Sidoqoftë, derisa praktika aktuale nuk përjashton plotësisht përgjegjësinë penale mbi pjesën e gjyqtarëve për dështime të paqëllimshme gjatë zbatimit të funksionit të tyre, KKGJE nuk mendon që futja e përgjegjësisë së tillë është përgjithësisht e pranueshme apo për t'u inkurajuar. Një gjyqtarë nuk duhet të funksionoj nën kërcënim me gjobë financiare apo burgim prania e cilit mund edhe pse nën-ndërgjegje, të ndikoj në gjykimin e tij.
54. Ndjekja shqetësuese e procedura penale kundër një gjyqtari të cilin një ndërgjygjës nuk e pëlqen është bërë e zakonshme në disa shtete Evropiane. KKGJE mendon që në shtetet ku një hetim penal apo procedurë mund të nisët me kërkesën e një individi privat, aty duhet ekzistuar një mekanizëm për parandalimin apo ndaljen e hetimeve apo procedurave të tilla kundër një gjyqtari lidhur me performansës domethënëse të zyrës së tij apo saj atëherë kur nuk ka rast për të sugjeruar që ekziston përgjegjësi penale nga ana e gjyqtarit.

b. Përgjegjësia civile

55. Shqyrtime të ngjashme me ato të identifikuar në paragrafin 53 zbatohen në imponimin e përgjegjësisë civile në gjyqtarë për pasojat e vendimeve të gabuara të tyre apo për dështimet e tyre (p.sh. vonesë e tepërt). Si parim i përgjithshëm, gjyqtarët personalisht duhet të gëzojnë lirinë absolute nga përgjegjësia lidhur me ankesat kundër tyre lidhur me zbatimin në mirëbesim të funksioneve të tyre. Gabimet gjyqësore, pavarësisht lidhur me juridiksionin apo procedurën, në përcaktimin apo zbatimin e ligjit apo në vlerësimin e dëshmive, duhet të trajtohen me apel; dështime tjera gjyqësore që nuk mund të korrigjohen në këtë mënyrë (duke përfshirë p.sh. vonesën e tepërt) duhet të shpien tek ankesa nga ndërgjygjësi i pakënaqur kundër Shtetit. Në disa rrethana, shteti mundet të jetë përgjegjës sipas Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut për kompensimin e ndërgjygjësit dhe kjo është një çështje tjetër cila nuk është trajtuar drejtpërdrejtë nga ky opinion.
56. Megjithatë, ekzistojnë disa vende evropiane ku gjyqtarët mund të kenë përgjegjësi civile për vendime të gabuara të rënda apo dështime tjera të rënda⁷, posaçërisht në instancë të shtetit pasi që ndërgjygjësi i pakënaqur ka fituar drejtën për kompensim kundër shtetit. Prandaj, për

⁷ Vetëm pse Shteti është përgjegjës për vonesë të tepërt, nuk dmth që është gabimi i ndonjë gjyqtari individual. KKGJE përsërit atë çfarë deklaron në paragrafin 27 më lart.

shembull në Republikën Çeke, shteti mund të jetë përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga vendimet e jashtëligjshme të gjyqtarit apo veprimet e gabuara gjyqësore, por mund të kërkohe ndihma e gjyqtarit nëse dhe pasi që keqsjellja e gjyqtarit ka ndodh në procedurat penale apo disiplinore. Në Itali shteti mund që në kushte të caktuara të kompensohet nga gjyqtari i cili është gjetur përgjegjës për ndonjë mashtrim të qëllimshëm apo “neglizhencë të rëndë” ku kjo e fundit i nënshtrohet kufizimit potencial të përgjegjësisë.

57. Akti Evropian mbi statutin e gjyqtarëve parasheh mundësinë e procedurave mbështetëse të kësaj natyre në paragrafin 5.2 të tekstit – me një mbrojtje që duhet të ekzistojë marrëveshja paraprake me autoritet të pavarur me përfaqësim substancial gjyqësor siç është përmendur në paragrafin 43 të opinionit nr. 1 (2001) të KKGJE-s. Komentet e Aktit në paragrafin 5.2 theksojnë nevojën për kufizimin e përgjegjësisë civile të gjyqtarit në (a) kompensimin e shtetit për (b) “neglizhencë të rëndë dhe të pafalshme” përmes (c) procedurave ligjore (d) duke kërkuar marrëveshje paraprake të një autoriteti të tillë të pavarur. KKGJE përkrah të gjitha këto pikë dhe vazhdon tutje. Aplikimi i koncepteve siç është neglizhenca e rëndë dhe e pafalshme shpeshherë është e vështirë. Nëse ekziston ndonjë potencial për ndonjë veprim mbështetës nga shteti, gjyqtari do të jetë i detyruar të shqetësohet në fazën kur ankesa është parashtruar kundër shtetit. Konkludimi i KKGJE-s është që është e papërshtatshme për një gjyqtarë të ekspozohet lidhur me ushtrimin domethënës të funksioneve gjyqësore ndonjë përgjegjësie personale madje edhe përmes kompensimit shtetit përpos në rast të shkeljes së qëllimshme.

c. Përgjegjësia disiplinore

58. Të gjitha sistemet ligjore kanë nevojë për një formë të sistemit disiplinor edhe pse nga përgjigjet e shteteve të ndryshme anëtare në pyetësorë është e qartë që kjo nevojë ndjehet më shumë në disa shtete anëtare. Lidhur me këtë, ekziston një dallim themelor ndërmjet shteteve të ligjit zakonor me gjyqësorë më të vogël profesional të emëruar nga radhët e praktikantëve me përvojë dhe shteteve të ligjit civil me gjyqësorë më të madh me mesatarisht të ri dhe karrieristë.

59. Pyetjet që janë ngritur janë:

- i) Çfarë sjellje duhet të bëjë një gjyqtarë për t’iu nënshtuar procedurave disiplinore?
- ii) Kush dhe si duhet të nisë këto procedura?
- iii) Kush dhe si duhet të përcaktohen ato?
- iv) Çfarë sanksionesh duhet të jenë në dispozicion për keqsjellje të vërtetuar në procedurë disiplinore?

60. Lidhur me pyetjen (i), pika e parë cilën KKGJE identifikon (duke përsëritur substancialisht komentet e dhëna më herët në këtë opinion) është që është gabim të bëhet lidhje ndërmjet

shkeljeve të standardeve të zakonshme profesionale me keqsjellje që potencialisht shkakton sanksione disiplinore. Standardet profesionale, që kanë qenë lëndë e pjesës së parë të këtij opinioni, paraqesin praktikën më të mirë e cila duhet të jetë synim i të gjithë gjyqtarëve. Do të shkurajonte zhvillimin e ardhshëm të standardeve të tillë dhe të keqkuptoj qëllimin e tyre për barazimin e tyre me keqsjelljen që arsyeton procedurat disiplinore. Për të arsyetuar procedurat disiplinore, keqsjellja duhet të jetë flagrante dhe e rëndë në atë mënyrë që ajo të mos ketë pasur mundësi të ndodh thjeshtë nga dështimi i vështimit të standardeve profesionale të paraparë me direktivë siç është diskutuar në pjesën e parë të këtij opinioni.⁸

61. Kjo nuk do të thotë shkelja e standardeve profesionale të identifikuar në këtë opinion nuk ka rëndësi të konsiderueshme ku është pretenduar që ka pasur keqsjellje të mjaftueshme për të arsyetuar dhe kërkuar sanksione disiplinore. Disa nga përgjigjet në pyetësorë identifikojnë këtë në mënyrë eksplicite: për shembull, standardet profesionale janë përshkruar si ekzistenca “e autoritetit të caktuar” në procedurë disiplinore në Lituani dhe si krijim i mënyrës për “të ndihmuar gjyqtarët në seancat disiplinore dëgjimore duke theksuar dispozitat e ligjit mbi gjyqtarët” në Estoni. Gjithashtu janë shfrytëzuar në procedurat disiplinore në Moldavi. (Në anën tjetër, përgjigjet e Ukrainës dhe Sllovakisë mohojnë lidhjen ndërmjet këtyre dy).
62. Në disa vende, janë vendosur sisteme të ndara për të tentuar rregullimin apo zbatimin e standardeve profesionale. Në Slloveni, dështimi në vështimin e standardeve mund të nxit sanksione në “Gjykatën e Nderit” brenda Shoqatës së Gjyqtarëve dhe jo para organit disiplinor të gjyqtarëve. Në Republikën Çeke, në situata të veçanta serioze të mos-vështimit të rregullave të sjelljes profesionale, gjyqtari mund të përjashtohet nga “Sindikata e Gjyqtarëve” që është burimi i këtyre parimeve.
63. Pika e dytë të cilën identifikon KKGJE është që secili Shtet duhet të specifikojë me ligj se çfarë sjelle mund të shkaktojë veprime disiplinore. KKGJE thekson që në disa vende është bërë përpjekje për të specifikuar hollësisht të gjitha sjelljet që mund të jenë bazë për procedura disiplinore që shpien tek disa forma të sanksioneve. Prandaj, ligji turk mbi Gjyqtarët dhe Prokurorët specifikon shkallët e shkeljeve (duke përfshirë për shembull largimin nga puna pa arsyetim për periudha të ndryshme kohore) me shkallë të sanksioneve duke u shtrirë nga paralajmërimi deri tek dënimi (dmth qortimi), efekte të ndryshme në gradim tek transferimi dhe përfundimisht largimi. Ngjashëm, ligji i fundit i Sllovenisë i vitit 2002 kërkon ndikimin e parimit të përgjithshëm nulla poena sine lege duke specifikuar 27 kategori të shkeljeve disiplinore. Megjithatë, vërehet në gjitha përpjekjet që përfundojnë në formulime të përgjithshme që vënë në dyshim gjykimin dhe shkallën. KKGJE nuk mendon që është e nevojshme (përmes meritës së parimit nulla poena sine lege apo ndonjë bazë tjetër) apo madje e mundshme të kërkohej të

⁸ Për këto arsye Pala Punuese e KKGJE gjatë dhe pas takimit të vet me Komisionarin e Kombeve të Bashkuara për Drejtat e Njeriut më 18 qershor 2002, ka cilësuar qëndrimin pozitiv dhe substancial ndaj Kodit të Bangallorit në draftin aktual duke mos u pajtuar me lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet parimeve të sjelljes që parasheh dhe ankesat dhe disiplinë (shih paragrafin 2(iii) të Shtojcës V, dok. CCJE-GT (2002) 7): shih komentet e CCJE-GT Nr. 1 (2002) mbi draftin e Bangallorit.

specifikohet saktësisht apo hollësisht termi në nivel evropian e natyrës së të gjitha keqsjelljeve që mund të shkaktojnë procedura disiplinore apo sanksione. Thelbi i procedurave disiplinore qëndron në sjelljen që është kryesisht në kundërshtim me atë çfarë pritet nga një profesionist në pozitën e personit që pretendohet të ketë shfaqur keqsjellje.

64. Në shikim të parë, Parimi VI.2 i Rekomandimit Nr. R (94) 12 mund të konsiderohet që sugjeron që duhet “definuar” paraprakisht bazë të saktë për procedura disiplinore dhe me “terme të sakta ligjore”. KKGJE plotësisht pranon që arsyet e sakta duhet të ofrohen për veprime disiplinore atëherë kur të propozohet dhe të paraqitet. Por, siç është thënë, nuk mendon që është e nevojshme apo madje e mundur në nivel evropian të kërkohet definimi paraprak i të gjitha arsyeve potenciale me terme tjera se sa formulime të përgjithshme aktualisht të aprovuara nga shumica e vendeve evropiane. Prandaj, lidhur me këtë KKGJE konkludon që qëllimi i cekur në paragrafin 60 c) në Opinionin Nr. 1 (2001) nuk mund të ndjeket në nivel evropian.
65. Definime të mëtutjeshme nga Shtete individuale anëtare sipas ligjit për arsye të sakta për veprime disiplinore siç është Rekomandimi Nr. R (94) 12 siç duket janë të dëshirueshme. Aktualisht, baza për veprime disiplinore zakonisht ceket me shprehje të përgjithshme.
66. KKGJE më pas i përgjigjet pyetjes (ii): kush dhe si duhet nisur procedurat disiplinore? Procedurat disiplinore në disa vende paraqiten nga Ministria e Drejtësisë, në disa tjera niset nga apo bashkërisht me gjyqtarë të caktuar apo këshillë të gjyqtarëve apo prokurorë, siç është Presidenti i Lart i Gjykatës së Apelit në Francë apo Prokurori i Përgjithshëm Publik në Itali. Në Angli, iniciatori është Kancelari i dhomës së Lordëve por ai është pajtuar vetëm të iniciojë procedurat disiplinore me pajtimin e Kryetarit të Gjyqësorit.
67. Një pyetje e rëndësishme është çfarë, nëse duhet, hapash të ndërmerren nga persona që pretendojnë me arsye të jenë dëmtuar nga gabimet profesionale të gjyqtarit. Këta persona duhet të kenë të drejtën të parashtrojnë ankesën personit apo organit përgjegjës për nisjen e veprimeve disiplinore. Por, ata nuk mund të kenë të drejtën të nisin apo këmbëngulin për veprim disiplinor. Duhet të ekzistojë një filtër përndryshe gjyqtarët shpesh do të ballafaqohen me procedura disiplinore të nisura nga ndërgjygjës të zhgënjyer.
68. KKGJE mendon që procedurat që shpiten tek nisja e veprimeve disiplinore kërkojnë një formalizim më të lart. Ajo propozon që shtetet duhet të përpiqen të vendosin organe apo persona të caktuar në çdo vend me përgjegjësi për pranimin e ankesave, për marrjen e përfaqësimeve të gjyqtarëve dhe për vendosjen nëse ka rast të mjaftueshëm kundër gjyqtarit për të nisur veprimet disiplinore me ç’rast do të përcjell rastin tek autoriteti disiplinor.
69. Pyetja e radhës (iii) është: kush dhe si duhet përcaktuar procedurat disiplinore? I tërë neni i Parimeve Themelore të Kombeve të Bashkuara iu është kushtuar disiplinës, suspendimit dhe largimit. Neni 17 parasheh “drejtën për dëgjim të drejtë” për gjyqtarë. Sipas Nenin 19, “të gjitha

(...) procedurat gjyqësore do të përcaktohen në përputhje me standardet e pranuar të sjelljes gjyqësore”. Në fund, Neni 20 parasheh parimin që “vendimet në procedurat disiplinore, suspendim apo largim duhet t’i nënshtrohen një shqyrtimi të pavarur”. Në nivel evropian, është ofruar udhëzimi në Parimin VI të Rekomandimit Nr. R (94) 12 i cili rekomandon që masat disiplinore të trajtohen nga “organi special kompetent i cili është i ngarkuar për zbatimin e sanksioneve dhe masave disiplinore, atëherë kur nuk janë trajtuar nga gjykata dhe vendimet e kujt do të kontrollohen nga organi suprem gjyqësor apo cili është vet organ suprem gjyqësor” dhe që gjyqtarët në lidhje me këtë do të përfitojnë së paku përmes mbrojtjes së barabartë me ato të parapara me Nenin 6.1 të Konventës për Drejtat e Njeriut. Gjithashtu, KKGJE thekson në këtë kontekst që masat disiplinore përfshijnë të gjitha masat me ndikim të kundërt në statusin apo karrierën e gjyqtarit duke përfshirë transferim nga gjykata, humbjen e drejtës për gradim dhe pagë.

70. Përgjigjet në pyetësorë tregojnë që në disa vende disiplina sigurohet nga gjykata e specializuar në raste të llojit të tillë: komisioni disiplinor i Gjykatës Supreme (Estonia, Sllovenia – aty ku përfaqësohet niveli i tillë). Në Ukrainë ekziston komisioni që përfshin gjyqtarët e nivelit të njëjtë të juridiksionit si gjyqtari në fjalë. Në Sllovakia tashmë ekzistojnë dy komisione, një prej tre gjyqtarëve, e dyta prej pesë gjyqtarëve nga Gjykata Supreme. Në Lituani ekziston komisioni i gjyqtarëve nga radhë të ndryshme të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatave administrative. Në disa vende, gjykimi lëshohet nga Këshilli Gjyqësor që vepron si gjykatë disiplinore (Moldavi, Francë, Portugali).⁹
71. KKGJE tashmë ka shpreh mendimin që procedurat disiplinore kundër një gjyqtari duhet të përcaktohen vetëm nga autoriteti i pavarur (apo “tribunali”) që drejton procedurat që garantojnë drejtën e plotë të mbrojtjes – shih para. 60(b) të Opinionit Nr. 1 (2001) të KKGJE-s mbi standardet për pavarësinë e gjyqësorit dhe pandërrueshmërinë e gjyqtarëve. Ajo gjithashtu mendon që organi përgjegjës për emërimin e tribunalit të tillë mund dhe duhet të jetë organ i pavarur (me përfaqësim substancial gjyqësor i përzgjedhur në mënyrë demokratike nga gjyqtarët tjerë) i cili, ashtu siç avokon KKGJE në paragrafin 46 të Opinionit të parë, duhet të jetë në përgjithësi përgjegjës për emërimin e gjyqtarëve. Kjo assesi nuk përjashton përfshirjen në anëtarësim në tribunal disiplinor nga persona tjerë përpos gjyqtarëve (kështu duke mënjanuar rrezikun e korporatizmit) gjithmonë duke paraparë që persona të tillë nuk janë anëtarë të legjislacionit, qeverisë apo administratës.
72. Në disa vende, organi fillestarë disiplinor është organi më i lart gjyqësor (Gjykata Supreme). KKGJE mendon që marrëveshjet lidhur me procedurat disiplinore në çdo vend duhet të jetë të

⁹ Në Angli, Kancelari është përgjegjës për nisjen dhe vendosje në një veprim disiplinor. Me marrëveshje, veprimi disiplinor nis vetëm me pajtim të Kryetarit të Gjyqësorit dhe më pas (përpos nëse gjyqtari në fjalë heq dorë nga kjo) një gjyqtarë tjetër me pozitë të duhur i emëruar nga Kryetari i Gjyqësorit emërohet për të hetuar faktet dhe për të raportuar, me rekomandime. Nëse Kryetari i Gjyqësorit pajtohet, Kancelari mund të dërgoj çështjen në Parlament (në rastin e radhëve më të lart të gjyqtarëve) apo të largoj gjyqtarin e instancës më të ulët nga zyra apo të ndërmerr apo autorizojë ndonjë veprim tjetër disiplinor.

tillë që të lejojnë një ankesë nga organi fillestarë disiplinor (pavarësisht a është vet autoritet, tribunal apo gjykatë) deri në gjykatë.

73. Pyetja e fundit (iv) është: çfarë sanksionesh duhet të jenë në dispozicion për keqsjelljen e vërtetuar në procedurat disiplinore? Përgjigjet në pyetësor zbulojnë disa dallime, padyshim që reflektohen në sisteme të ndryshme ligjore dhe urgjenca. Në sistemet e ligjit zakonor, me gjyqësorë të vogël dhe homogjen të përbërë nga jurist më të moshuar dhe me përvojë, sanksioni i vetëm formal që është gjetur të jetë i nevojshëm (dhe si mundësi e largët mbështetëse) është masa ekstreme e largimit por gjithashtu vërejtjet joformale dhe kontaktimi mund të jenë shumë efektiv. Në vende tjera, me gjyqësor më të madh dhe më të ndryshëm dhe në disa raste me më pak përvojë, shkallëzimi i sanksioneve formalisht të shprehura është zbuluar të jetë i përshtatshëm madje nganjëherë duke përfshirë ndëshkime financiare.
74. Akti Evropian mbi Statutin e Gjyqtarëve (Neni 5.1) parasheh që “shkalla e sanksioneve që mund të caktohen është e paraparë me statut dhe duhet t’i nënshtrohet parimit të proporcionalitetit”. Disa shembuj të sanksioneve të mundshme paraqiten në Rekomandimin Nr. R (94) 12 (Parimi VI.1). KKGJE përkrah nevojën që çdo juridiksion të identifikoj sanksionet e lejueshme sipas sistemit të vet disiplinor dhe këto sanksione të jenë në parim dhe në zbatim proporcionale. Por nuk mendon që një listë definitive duhet dhe nuk mund të synohet në nivel evropian.

5°) Konkludimet për përgjegjësitë

75. Lidhur me përgjegjësinë penale, KKGJE mendon që:

- i) Gjyqtarët duhet të kenë përgjegjësi penale në ligjin e zakonshëm për shkeljet jashtë zyrës gjyqësore;
- ii) Përgjegjësia penale nuk duhet të imponohet gjyqtarëve për dështime të paqëllimshme gjatë zbatimit të funksionit të tyre.

76. Lidhur me përgjegjësinë civile, duke pasur parasysh parimin e pavarësisë, KKGJE mendon që:

- i) Korrigjimi për gabime gjyqësore (lidhur me juridiksionin, substancën apo procedurën) duhet të qëndrojë në sistemin e përshtatshëm të ankesave (me ose pa leje të gjykatës);
- ii) Korrigjimi i dështimeve tjera në administrimin e zyrës (duke përfshirë për shembull vonesa të tepërta) mbetet vetëm tek shteti;
- iii) Nuk është e përshtatshme që një gjyqtarë t’i nënshtrohet, lidhur me ushtrimin domethënës të funksioneve gjyqësore, përgjegjësisë personale madje edhe me kompensimin e shtetit përpos në rast të dështimit të qëllimshëm.

77. Lidhur me përgjegjësinë disiplinore, KKGJE mendon që:

- i) Në çdo vend, statuti apo akti fundamental që zbatohet për gjyqtarë duhet të definoj sa më shumë që të jetë e mundur me terme specifike, gabimet që mund të shkaktojnë sanksione disiplinore si dhe procedurat që pasojnë;
- ii) Lidhur me institucionin për procedura disiplinore, shtetet duhet të përpiqen të vendosin një organ apo person specifik me përgjegjësi për pranimin e ankesave, për marrjen e përfaqësimeve të gjyqtarëve dhe shqyrtimin nëse ka apo jo rast të mjaftueshëm kundër gjyqtarit për të kërkuar nisjen e procedurave të tilla;
- iii) Çdo procedurë e nisur disiplinore duhet të përcaktohet nga autoriteti i pavarur apo tribunali që drejton procedurën duke garantuar drejtën e plotë të mbrojtjes;
- iv) Nëse autoriteti i tillë nuk është gjykatë, atëherë anëtarët e tij duhet të emërohen nga autoriteti i pavarur (me përfaqësim substancial gjyqësor të përzgjedhur në mënyrë demokratike nga gjyqtarët tjerë) të avokuar nga KKGJE në paragrafin 46 të Opinionit Nr. 1 (2001);
- v) Marrëveshjet lidhur me procedurat disiplinore në çdo vend duhet të jenë të tilla për të lejuar një ankesë nga organi fillestare disiplinorë (pavarësisht nëse është vet autoritet, tribunal apo gjykatë) deri tek gjykata;
- vi) Sanksionet në dispozicion për një autoritet të tillë në rast të keqsjelljes së vërtetuar duhet të jenë të përcaktuara sa më shumë që të jetë e mundur me terma specifik me statut apo akt fundamental të gjyqtarëve dhe duhet të zbatohet në mënyrë proporcionale.